



Fshati Prush, Komuna Vaqarr, Tirane-Albania

Mob:+355(0)682084945

E: info@helpthelife.org.al

W: www.helpthelife.org

TERMA REFERENCE (ToR)

Pozicioni: Kuzhinier

Qendra Sociale Multifunkionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara

Organizata: Shoqata “NdiHmoni Jetën”

Vendndodhja: Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj (me mundësi rinovimi)

Forma e punësimit: Me kohë të plotë

1. Hyrje – Qëllimi i qendrës

Qendra Sociale Multifunkionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara, e administruar nga Shoqata “NdiHmoni Jetën”, ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të integruara sociale, dhe mbështetëse për persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe me çrregullim të spektrit të autizmit, si dhe për familjet dhe kujdestarët e tyre. Qendra synon të përmirësojë cilësinë e jetës së përfituesve, të rrisë pavarësinë, autonominë dhe aftësitë funksionale të tyre, si dhe të promovojë përfshirjen aktive sociale dhe komunitare, në përputhje me parimet e jetesës së pavarur, barazisë, mosdiskriminimit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.

2. Përshkrimi i rolit

Kuzhinieri do të jetë përgjegjës për përgatitjen e ushqimit për përdoruesit e shërbimeve të Qendrës Sociale Multifunkionale, duke siguruar standarde të larta higjienike, cilësore dhe ushqimore, në përputhje me nevojat dietike dhe programet e qendrës.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme

Punonjësi/ja do të:

- Përgatitja e vakteve ditore për përdoruesit e qendrës sipas planifikimeve të dietës dhe menusë së aprovuara.
- Sigurimi i kushteve higjienike në kuzhinë dhe ruajtja e pajisjeve dhe materialeve në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore.
- Kontrolli i cilësisë së ushqimeve dhe monitorimi i afatit të përdorimit të produkteve.
- Bashkëpunimi me stafin social dhe psikologjik për të përshtatur ushqimin me nevojat e përdoruesve (p.sh., dieta speciale për fëmijë, ose persona me nevoja të veçanta shëndetësore).
- Mbajtja e inventarit të materialeve dhe raportimi i mungesave ose nevojave për furnizime.

4. Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit

- Arsimi minimal i mesëm profesional në fushën e gastronomisë ose ushqimit.
- Përvojë e dëshmuar në përgatitjen e ushqimit, preferohet në institucione sociale, shkolla ose restorante.
- Njohuri mbi standardet e higjienës dhe sigurisë ushqimore.
- Aftësi organizative dhe menaxhimi i kohës.
- Aftësi bashkëpunimi dhe komunikimi me stafin dhe përdoruesit e qendrës.



Fshati Prush, Komuna Vaqarr, Tirane-Albania
Mob:+355(0)682084945
E: info@helphthelife.org.al
W: www.helphthelife.org

5. Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këto Terma Reference, ftohen të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda afatit të përcaktuar, jo më vonë se data 30.01.2026 ora 17:00:

- Letër motivimi, ku të shpjegohet interesi për pozicionin dhe mënyra se si kandidati/ja i plotëson kriteret e kërkuara;
- Curriculum Vitae (CV) e detajuar dhe e përditësuar;
- Kopje e diplomës se shkollës , sipas kërkesës së pozicionit;
- Dokumente të tjera mbështetëse (certifikata trajnimesh, referenca pune, etj.), nëse aplikohen.
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Dokumentet duhet të dorëzohen në adresën e email: info@helphthelife.org.al me subjekt : Aplikim per pune (duke specifikuar pozicionin e dëshiruar).

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për fazat e mëtejshme të procesit të përzgjedhjes.